



Prishtinë: 31.03.2022
Kodi i ZRRE-së: V_1503_2022

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Dëshmitë e paraqitura nga palët; dhe
- Rekomandimin e DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_R_2281_02_22**.

në seancën e mbajtur më datë 31.03.2022 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** ankesa e konsumatorit **B.Th.**, nga Klina, si në arsyet e paraqitura në këtë vendim.
- II. **KESCO** duhet të anulojë korrigjimet plotësuese 60804DPE-9043188, 60805DPE-9043188, 60806DPE-9043188 datë 12.07.2019 në vlerë **3,598.19€**, faturat 07130DPE-9043188 datë 04.08.2013 në vlerë **1,143.61€** dhe 081369958DPE-9043188 datë 04.09.2013 në vlerë **396.21€**
- III. **KESCO** për periudhën korrik 2013 duhet ta ngarkoj konsumatorin me shpenzimet e periudhës gusht 2013 në vlerë **1,616.49 €**

A r s y e t i m

B.Th. me datë 14.11.2019 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në Zyrën e Rregullatorit për Energji, duke kundërshtuar përgjigjen e Departamentit për Konsumator në KESCO lidhur me korrigjimeve plotësuese nr.60804DPE-9043188, nr.60805DPE-9043188 dhe nr.60806DPE-9043188 datë 12.07.2019.

Me datë 27.06.2013 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar piken matëse të konsumatorit ku kanë evidentuar shpenzimet e regjistruara në njehsorin elektrik nr. 35719701 me gjendje të njehsorit elektrik aktiv TL=01213,00 kWh dhe TU=00090,00 kWh dhe gjendja e njehsorit reaktiv TL=01172,00 kVar dhe TU=00092,00 kVar. Ekipi i KEDS-it po ashtu ka bërë shqyrtimin e njehsorit ku ka evidentuar se kontrollohet GM dhe TMRR të cilat janë në rregull dhe të bllobuara dhe mufizuara. Po ashtu bëhet matja me Amperdana dhe rezultojnë brenda kufijve të lejuara ku: në primar: R=110,4A, S=112,3A dhe T=104,3A kurse në Sekondare: R=1,321A, S=1,437A dhe T=1,406A.

Provë: Procesverbal i inspektimit nr. 0103447 datë 27.06.2013

Me datë 29.07.2013 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar piken matëse të konsumatorit ku kanë evidentuar shpenzimet e regjistruara në njehsorin elektrik nr. 35719701 me gjendje të njehsorit elektrik aktiv TL=1374 kWh dhe TU=97 kWh dhe gjendja e njehsorit reaktiv TL=1338 kVar dhe TU=97 kVar. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar në procesverbal që gjatë kontrolles është konstatuar se në ekranin e njehsorit elektrik mungon tensioni për matje (L3). Të nxirret nga AMR



koha nga kur mungon ky tension. Po ashtu kanë evidentuar që ekipet e matjeve të dalin në vend dhe të rregullojnë grup matësin.

Provë: Procesverbal i inspektimit nr. 0059636 datë 29.07.2013

Me datë 30.07.2013 punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë bërë inspektimin e pikës matëse, ku kanë demontuar grupin matës nr.35719701, me gjendje të njehsorit elektrik aktiv TL=1380,480 kWh dhe TU=93,108 kWh dhe gjendja e njehsorit reaktiv TL=1344,120 kVAr dhe TU=97,130 kVAr dhe kanë vendosur për matje grupin matës nr. 35754959 me gjendje të njehsorit elektrik aktiv TL=00000,000 kWh dhe TU=00000,000 kWh dhe gjendja e njehsorit reaktiv TL=00000,000 kVAr dhe TU=00000,000 kVAr dhe konstant llogaritëse C=80. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar në procesverbal që njehsori ndërrohet pasi që një tension nuk i lajmërohet në display e as në program. Korigjimi duhet të bëhet nëse ka nevojë sipas shënimeve në AMR. Po ashtu në procesverbal është evidentuar se njehsori duhet urgjent të dërgohet në qendrën e kalibrimit.

Provë: Procesverbal i montimit dhe demontimit si dhe montimit të grupit matës nr. 004126 i datës 30.07.2013

Departamenti i faturimit në KEDS me datë 17.09.2013 e ka ngarkuar konsumatorin me korigjimet plotësuese 33860DPE-9043188, 33861DPE-9043188 dhe 33862DPE-9043188 në vlerë financiare **9,980.79€** duke bërë korigjimin plotësues për periudhën 28.10.2012 deri në periudhën 30.07.2013 për shkak të mos regjistrimit të shpenzimeve në njërin fazë.

Provë: Korigjimet nr.33860DPE-9043188, nr.33861DPE-9043188 dhe nr.33862DPE-9043188 datë 17.09.2013

Me datë 30.04.2019 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kundërshtuar korigjimet plotësuese nr.33860DPE-9043188, nr.33861DPE-9043188 dhe nr.33862DPE-9043188 datë 17.09.2013.

Provë: Ankesa e konsumatorit datë 30.04.2019

Me datë 24.10.2019 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e aprovuar pjesërisht ankesën e tij ku ka anuluar korigjimet nr.33860DPE-9043188, nr.33861DPE-9043188 dhe nr.33862DPE-9043188 në vlerë financiare **9,980.79€** por që përmes korigjimeve plotësuese nr.60804DPE-9043188, nr.60805DPE-9043188 dhe nr.60806DPE-9043188 me datë 12.07.2019 ka ngarkuar konsumatorin në vlerë **3,598.19€**.

Provë: Përgjigja e KESCO-s e datës 24.10.2019

Me datë 14.11.2019 konsumatori ka parashtruar ankesë në DMK të ZRRE-së duke kundërshtuar përgjigjen e lëshuar nga KESCO si dhe ka kërkuar të shqyrtohen korigjimet plotësuese nr.60804DPE-9043188, nr.60805DPE-9043188 dhe nr.60806DPE-9043188 datë 12.07.2019.

Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së datë 14.11.2019

Bordi i ZRRE-së duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit dhe KEDS/KESCO, ka vërejtur se:

Me datë 27.06.2013 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë evidentuar shpenzimet e regjistruara në njehsorin elektrik nr. 35719701 me gjendje të njehsorit elektrik aktiv TL=01213,00 kWh dhe TU=00090,00 kWh dhe gjendja e njehsorit reaktiv TL=01172,00 kVAr dhe TU=00092,00 kVAr. Ekipi i KEDS-it po ashtu ka bërë shqyrtimin e njehsorit ku ka evidentuar se kontrollohet GM dhe TMRR (400/5A) të cilat janë në rregull dhe të bllobuara dhe mufizuara. Po ashtu bëhet matja me Amperdana dhe matjet rezultojnë brenda



kufijve te lejuara ku: Rrymat ne primar: R=110,4A, S=112,3A dhe T=104,3A kurse ne Sekondar: R=1,321A, S=1,437A dhe T=1,406A.

Me datë 29.07.2013 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse te konsumatorit ku kanë evidentuar shpenzimet e regjistruara ne njehsorin elektrik nr. 35719701 me gjendje të njehsorit elektrik aktiv TL=1,374 kWh dhe TU=93 kWh dhe gjendja e njehsorit reaktiv TL=1,338 kVAR dhe TU=97 kVAR. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar ne procesverbal qe gjatë kontrollës është konstatuar se ne ekranin e njehsorit elektrik mungon tensioni per matje (L3). Te nxirret nga AMR koha nga kur mungon ky tension. Po ashtu kanë evidentuar qe ekipet e matjeve te dalin ne vend dhe te rregullojnë Grup matësin.

Me datë 30.07.2013 punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë bërë inspektimin e pikës matëse, ku kanë demontuar grupin matës nr.35719701, me gjendje të njehsorit elektrik aktiv TL=1380,480 kWh dhe TU=93,108 kWh dhe gjendja e njehsorit reaktiv TL=1344,120 kVAR dhe TU=97,130 kVAR dhe kanë vendosur per matje grupin matës nr. 35754959 me gjendje të njehsorit elektrik aktiv TL=00000,000 kWh dhe TU=00000,000 kWh dhe gjendja e njehsorit reaktiv TL=00000,000 kVAR dhe TU=00000,000 kVAR dhe konstant llogaritëse C=80. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar ne procesverbal qe njehsori ndërrohet pasi qe një tension nuk i lajmërohet ne display e as ne program. Korrigjimi duhet te behet nëse ka nevojë sipas shënimeve ne AMR. Po ashtu ne procesverbal është evidentuar se njehsori duhet urgjent te dërgohet ne qendrën e kalibrimit.

Departamenti i faturimit në KEDS me datë 17.09.2013 e ka ngarkuar konsumatorin me korrigjimet plotësuese nr. 33860DPE-9043188, nr. 33861DPE-9043188 dhe nr. 33862DPE-9043188 në vlerë financiare **9,980.79€** duke bërë korrigjimin plotësues për periudhën 28.10.2012 deri ne periudhën 30.07.2013 per shkak te mos regjistrimit te shpenzimeve ne njëren fazë. Me datë 30.04.2019 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kundërshtuar korrigjimet plotësuese nr. 33860DPE-9043188, nr. 33861DPE-9043188 dhe nr. 33862DPE-9043188 datë 17.09.2013. Me datë 24.10.2019 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e aprovuar pjesërisht ankesën e tij ku ka anuluar korrigjimet nr. 33860DPE-9043188, nr. 33861DPE-9043188 dhe nr. 33862DPE-9043188 në vlerë financiare **9,980.79€** per shkak se korrigjimi i bere është me i lartë se faturimi i asaj periudhe e i cili ka qenë **7,223.64€** e cila ka përfshi shpenzimet e regjistruara ne dy faza **si dhe është potencuar se mungon mënyra e kalkulimit te korrigjimit** por qe përmes korrigjimeve nr. 60804DPE-9043188, nr. 60805DPE-9043188, nr. 60806DPE-9043188 me datë 12.07.2019 ka ngarkuar konsumatorin me korrigjim plotësues ne vlerë **3,598.19€** duke bere korrigjimet e faturave për periudhën 28.10.2012 deri ne periudhën 30.07.2013 bazuar ne koeficientin e gabimit **K=1.5** ku përfshihet edhe korrigjimi i fuqisë se angazhuar per çdo muaj po me te njëjtin koeficient te korrigjimit.

Bordi i ZRRE ka analizuar tre procesverbalet e inspektimit, procesverbalin e inspektimit nr. 0103447 datë 27.06.2013, procesverbalin e inspektimit nr. 0059636 datë 29.07.2013 si dhe procesverbalin e montimit dhe demontimit si dhe montimin të grupit matës nr. 004126 i datës 30.07.2013 dhe konstaton se ekipi i KEDS-it edhe përkundër shqyrtimit ne plotni te grupit matës nr.35719701 me datë 27.06.2013 përfshi edhe sistemet e tjera matëse nuk ka evidentuar asnjë çrregullim ne matje përfshi edhe ne njehsorin elektrik kurse ne dy procesverbalet e tjera, pra procesverbalin nr. 0059636 datë 29.07.2013 dhe procesverbalin e montimit dhe demontimit si dhe montimin të grupit matës nr. 004126 i datës 30.07.2013 ka evidentuar se ka probleme me një tension, përkatësisht ne ekranin e njehsorit elektrik mungon tensioni per matje (L3). Bordi i ZRRE-së duke pasur parasysh analizën e këtyre tri



procesverbaleve si dhe mos përcaktimit të saktë të kohës kur njehsori nuk ka matur në një fazë në periudhën korrik 2013, konstaton se konsumatorit duhet të behet korrigjimi vetëm për periudhën korrik 2013 duke anuluar korrigjimet e faturave tjera. Korrigjimi i faturës për periudhën korrik 2013 duhet të behet bazuar në shpenzimet e regjistruara në njehsorin elektrik nr. 35754959 për periudhën gusht 2013 në vlerë **1,616.49 €** dhe të anulohet faturën 07130DPE-9043188 datë 04.08.2013 në vlerë **1,143.61€**. Po ashtu vërehet se në faturën 081369958DPE-9043188 të dërguar tek konsumatori me datë 04.09.2013 në vlerë **396.21 €** përveç ndryshimit të kWh të faturuar (TL=123.20 kWh dhe TU=00 kWh) është faturuar edhe fuqia por që e njëjta është faturuar në periudhën 07/2013 andaj duke pasur parasysh se faturimi i periudhës korrik 2013 anulohet dhe e njëjta korrigjohet sipas shpenzimit të periudhës gusht 2013 duhet të behet edhe anulimi i faturës 081369958DPE-9043188 datë 04.09.2013.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 31.03.2022 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit: **B.Th.**
- KESCO-së dhe
- Arkivit të ZRRE-së.